

Shtojca 1: Termat e Referencës / Përshkrimi i shërbimit

Titulli i programit:	KCSF
Titulli i kontratës:	Furnizimi dhe servisimi i gjeneratorit

HYRJE

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) është organizatë e pavarur, jofitimprurëse, që përkrahë zhvillimin e shoqërisë civile dhe nismat që promovojnë një kulturë demokratike dhe i përgjigjen nevojave socio-ekonomike të Kosovës, me fokus të veçantë në dhënien e kontributit për procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

FUSHËVEPRIMI I FURNIZIMIT/SHËRBIMIT

Qëllimi i aktivitetit është blerja e një gjeneratori që përmbushë nevojën e organizatës në rast të ndërprerjes së energjisë elektrike.

SPECIFIKAT TEKNIKE TË KËRKUARA (MINIMALE)

Standby Power: 225 kVA

DIESEL ENGINE:

Cycle (Rotation): 1500 RPM

Intake System: Turbocharger

Cooling Type: Water Cooled

ALTERNATOR:

Output Voltage (V): 230/400

Frequency (Hz) 50

Power Factor (cos Phi) 0,8

Pole Number 4

SPECIFIKA TJERA SHITESË

Niveli maksimal i zhurmës në Decibel 75 (dB)

Gjeneratori duhet të jetë i ri dhe i papërdorur

Kabinë e izoluar për zhurmë

Rezistent ndaj kushteve të ambientit të jashtëm

Kyqje automatike në rrjet

Lënda djegëse diesel (naftë)

Sqarime shtesë:

Në kuadër të ofertës për furnizim me gjenerator duhet të përfshihet edhe mirëmbajtja dhe servisimi i rregullt për një periudhë dyvjeçare nga data e pranimit të gjeneratorit.

Servisimi i rregullt duhet të bëhet në intervalet e përcaktuara kohore, ndërsa intervenimet me qëllim të sanimit të prishjeve të gjeneratorit mund të kërkohen në çdo kohë, sipas nevojës.

Operatori i suksesshëm ka për obligim që për gjenerator dhe pjesët përcjellëse të tij të ofrojë sqarime (nëse ka nevojë) dhe trajnim të personelit për operim me pajisje.

AFATI KOHOR

Afati kohor për dorëzim të pajisjes është 10 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës ndërsa servisimi i rregullt për një periudhë 2 vjeçare.

KËRKESAT PËR KUALIFIKIM

DEKLARATA NËN BETIM NGA PERSONI JURIDIK/FIZIK DHE PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Të gjithë ofertuesit duhet të paraqesin Deklaratën nën betim për kriteret e përjashtimit dhe parandalimi i konfliktit të interesit (shih Shtojcën 2), të nënshkruar nga përfaqësues i autorizuar i kompanisë ose personi fizik dhe duke cekur datën, duke deklaruar se ata nuk janë në një nga situatat e përjashtimit të renditura në Shtojcën 2.

PROPOZIMI TEKNIK

Propozimi teknik duhet të mbulojë të gjitha elementet e kërkuara në specifikimin teknik dhe të sigurojë të gjithë informacionet e nevojshme për të zbatuar kriteret e dhënies së kontratës. Ofertat që devijojnë nga kërkesat ose nuk mbulojnë të gjitha kërkesat mund të refuzohen në bazë të mosrespektimit të specifikimeve të tenderit.

PROPOZIMI FINANCIAR

Çmimi në propozimin financiar duhet të kuotohet në euro. Çmimet duhet të kuotohen pa përfshirë TVSH-në dhe shërbimet duhet të ofrohen me çmime fikse të njësisë.

TERMAT DHE KUSHTET

Ofertat e pranuar pas datës së pranimit të kërkesës të përcaktuar në në dosje të tenderit ose të dorëzuara në mënyrë jo të saktë në përputhje me këto udhëzime, mundet që, me diskrecionin e vetëm të KCSF-së, të mos merren parasysh dhe të kthehen mbrapa dhe refuzohen.

KCSF rezervon të drejtën për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat e pranuar ose kërkesat për shpjegime shtesë.

KCSF rezervon të drejtën për të negociuar me një ose disa ofertues të listës së ngushtë, pas vlerësimit fillestar të ofertave të dorëzuara.

Asnjë ofertë dhe asnjë pjesë e saj nuk do të konsiderohet se është miratuar, përveç nëse për miratimin e tillë ofertuesi është njoftuar me shkrim nga KCSF.

KCSF rezervon të drejtën për të ndërprerë ose modifikuar këtë ftesë.

Para dhënies së kontratës, KCSF mund të kërkojë nga ofertuesit që të ofrojnë informata shtesë ose të kërkojë takim ose inspektim të vendit/objektit për të ndihmuar procesin e vlerësimit.